Janar 2024 | Nr. 34

# BULETINI MUJOR

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani
@ILD_Albania

## METANI: NUK MUND TË NDALOHET ASKUSH TË THOTË ATË QË MENDON PËR PUNËN E INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË




Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” | Sheshi “Nënë Tereza” | Godina nr.13 | Tiranë, Shqipëri




## METANI: NUK MUND TË NDALOHET ASKUSH TË THOTË ATË QË MENDON PËR PUNËN E INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË

Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi një leksion të hapur me pjesëmarrësit e Akademisë së Integrimit Europian dhe Negociatave, në modulin "Pavarësia dhe efikasiteti i Sistemit të Drejtësisë – reformat para dhe pas anëtarësimit", në kuadër të









edicionit “Shteti i së Drejtës”.

Z. Metani bëri një prezantim të rolit dhe funksioneve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe iu përgjigj pyetjeve mbi institucionin që drejton, sistemin e ri të drejtësisë dhe pritshmëritë e publikut.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë nënvizoi rëndësinë që ka informimi për institucionet e drejtësisë dhe jo vetëm, sepse shumë flitet për ILD-në, edhe për institucione të tjera, por pak nga atë që flasin, ulen të lexojnë e kuptojnë rolin e këtyre institucioneve dhe kjo krijon premisa të gabuara që

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë nënvizoi rëndësinë që ka informimi për institucionet e drejtësisë dhe jo vetëm, sepse shumë flitet për ILD-në, edhe për institucione të tjera, por pak nga atë që flasin, ulen të lexojnë e kuptojnë rolin e këtyre institucioneve dhe kjo krijon premisa të gabuara që në koncept.**





në koncept.

"Dëgjoj referenca të tilla si "drejtësia e re" për shembull. – tha z. Metani. – Në fakt ka një sistem të ri drejtësie, e jo "drejtësi të re", sepse janë të njëjtët njerëz, që kanë qenë pjesë e një sistemi tjetër organizimi, e tani janë në një sistem të ri, me më shumë kompetenca e pavarësi."

Duke iu përgjigjur interesit të pjesëmarrësve mbi pritshmëritë publike nga drejtësia e institucionet e saj, z. Metani tha se nuk mund





**“Çdokush ka të drejtë të thotë, të shprehë atë që mendon për punën e organeve të drejtësisë. Mbrojtja më e mirë e jona është transparenca dhe thjeshtësia e qartësia e vendimeve tona. Pra që ato të jenë të kuptueshme e pa terma që krijojnë ekuivok, edhe për qytetarin e zakonshëm. Nëse institucionet janë të qarta e transparente, çdokush arrin ta bëjë vetë dallimin për cilësinë e punës së tyre. Nuk mund të ndalohet askush të thotë atë që mendon. pavarësi.”**

të ndalohet askush të thotë atë që mendon.

“Çdokush ka të drejtë të thotë, të shprehë atë që mendon për punën e organeve të drejtësisë. Mbrojtja më e mirë e jona është transparenca dhe thjeshtësia e qartësia e vendimeve tona. Pra që ato të jenë të kuptueshme e pa terma që krijojnë ekuivok, edhe për qytetarin e zakonshëm. Nëse institucionet janë të qarta e transparente, çdokush arrin ta bëjë vetë dallimin për cilësinë e punës së tyre. Nuk mund të ndalohet askush të thotë atë që mendon.
Niveli pastaj, natyrisht ka të bëjë me kulturën e secilit, formimin e informimin.
Por secili nga ne mund e duhet të flasë me punën e vet.”

Interesi i pjesëmarrësve, punonjës të institucioneve qendrore e vendore, të drejtësisë, të organizatave të shoqërisë civile, universiteteve, mediave dhe profesioneve të lira, vijoi edhe për sjelljen e magjistratëve, etikën, perceptimin publik në raport me realitetin.






## QYTETARI I ZAKONSHËM NË VËMENDJEN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Përgjatë vitit 2023, krahas veprimtarisë së përditshme funksionale të inspektimit, verifikimit, hetimit e procedimit disiplinor, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në punën e vet ka patur në vëmendje të posaçme raportin me qytetarin, në dy dimensione: si ankues për shkelje disiplinore të pretenduara ndaj gjyqtarëve e prokurorëve dhe si qytetar i informuar, përmes aktiviteteve për edukim ligjor përgjatë gjithë vitit me grupe të ndryshme shoqërore.

Qytetarët ankues kanë shërbyer si iniciues të disa inspektimeve të ndryshme tematike, të Zyrës së ILD-së gjatë vitit 2023. I tillë është inspektimi tematik mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve të gjykatave, iniciuar nga shqyrtimi i një numri të madh ankesash mbi pretendimet për zvarritjen e gjykimit dhe vonesat në zbardhjen e vendimeve nga gjyqtarët.
Ky inspektim që u krye në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, (Dhoma civile) dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka përfunduar.

Njëlloj, dinamika e ankesave të qytetarëve ka shërbyer për të iniciuar inspektimet tematike mbi caktimin e çështjeve në prokurori; mbi ndarjen e çështjeve me short dhe kontrollin e raporteve të sistemit elektronik në gjykata; si dhe mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve, inspektime tematike që janë në proces dhe në faza të ndryshme procedurale.

Një tjetër inspektim tematik, që është drejt përfundimit, ai i lirimit me kusht, është iniciuar që me nisjen punë të ILD-së, në vitin

2020, nisur nga ndjeshmëria e lartë publike në atë periudhë pas lirimeve të disa personazheve të njohur për drejtësinë.

Prej nisjes së funksionimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vëmendja ndaj qytetarëve-ankues ka qenë e lartë, si për ata që i janë drejtuar direkt ILD-së, por edhe për të tjerë, që ankesat e tyre i kishin depozituar prej vitesh në institucionet paraardhëse, të ngarkuara me procesin disiplinor të magjistratëve.

Kështu nga 33 kërkesa për procedim disiplinor të paraqitura prej vitit 2020 nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, 28 prej tyre janë mbi bazë ankese të depozituar nga qytetarët pranë ILD-së apo pranë institucioneve të mëparshme, por të trashëguara nga ILD-ja, e të hetuara prej saj. Angazhimi i qytetarëve ka qenë i lartë. Vetëm gjatë muajit dhjetor 2023, 100 ankesa janë depozituar nga qytetarët në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga të cilat, 40 ankesa vetëm javën e fundit të dhjetorit.

Duke patur parasysh parimin se një qytetar i informuar arrin të adresojë ku duhet problematikën që has, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë po ndjek një strategji komunikimi publik, që nis në institucion, me lehtësitë e krijuara për çdo ankues, përmes faqes së internetit, ku ndodhet një formular i dedikuar për t'u plotësuar, e më tej, çdo ditë, me pritjen dhe asistimin e qytetarëve, që duan të depozitojnë ankesë fizikisht apo të marrin informacion për ecurinë e ankesës së tyre.

Gjatë vitit 2023, Zyra e Ankesave dhe e marrëdhënieve me publikun ka pritur 237 qytetarë; ka realizuar 188 telefonata



**Gjatë vitit 2023, Zyra e Ankesave dhe e marrëdhënieve me publikun ka pritur 237 qytetarë; ka realizuar 188 telefonata sqaruese me qytetarë të interesuar dhe u është përgjigjur 202 kërkesave të paraqitura për informacion.Paralelisht ka vijuar komunikimi edhe jashtë institucionit, në funksion të transparencës dhe ndërgjegjësimit të publikut mbi misionin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Zyrës së ILD-së, përmes edukimit ligjor.**

sqaruese me qytetarë të interesuar dhe u është përgjigjur 202 kërkesave të paraqitura për informacion.

Paralelisht ka vijuar komunikimi edhe jashtë institucionit, në funksion të transparencës dhe ndërgjegjësimit të publikut mbi misionin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Zyrës së ILD-së, përmes edukimit ligjor. Për këtë Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka krijuar një traditë të bashkëbisedimeve me grupe të ndryshme shoqërore, që është intensifikuar gjatë vitit 2023.

Në 12 takime e konferenca, memorandume bashkëpunimi janë përfshirë kategori të ndryshme shoqërore, që nga nxënës, studentë e deri tek Organizatat e Shoqërisë Civile, të fokusuara tek sistemi i drejtësisë dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Një gjyq imitues nga nxënësit e shkollës 9 vjeçare "Besëlidhja e Malësisë", në qytetin e Bajram Currit, leksionet e hapura me studentë të drejtësisë të Universitetit të Vlorës e Elbasanit, shoqëruar me firmosjen e memorandumeve të bashkëpunimit, bashkëbisedim me studentët e Akademisë "Citizen in charge" në Tiranë, kanë qenë aktivitete të targetuara për nxitjen e edukimit ligjor, që nga sistemi parauniversitar deri në atë universitar.

Në funksion të synimit për të komunikuar me grupe interesi edhe nëpër rrethe, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka zhvilluar gjatë vitit 2023, dy tryeza bashkëbisedimi me Organizatat e Shoqërisë Civile në Lezhë dhe në Lushnjë, më mbështetjen e OSBE. Komunikimi i hapur në këto tryeza nxori në pah rëndësinë që ka paraqitja e institucionit tek grupet e ndryshme të interesit, aty ku ata jetojnë dhe diskutimet mbi mënyrën se si e shohin rolin e institucionit, eksperiencat dhe pritshmëritë në raport me sjelljen e magjistratëve në sistem.

Ky komunikim direkt i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i shërben rritjes së transparencës, por edhe të eficencës së punës së ILD-së, duke ndihmuar gjithashtu në rritjen e forcimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

Po gjatë vitit 2023, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka qenë objekt analizash studimore profesionale nga Organizata të Shoqërisë Civile, që kanë në fokus të punës,



monitorimin e sistemit të drejtësisë. Instituti për Studime Politike dhe Ligjore, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes dhe Infocip përmes eventeve të posaçme, kanë paraqitur dhe diskutuar bashkë me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, me profesionistë të fushës dhe përfaqësues institucionesh, ecurinë e veprimtarisë së ILD-së, sfidat dhe përparimet, si dhe vizionin për të ardhmen.

Në këtë bilanc fundviti, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjen rastin të falenderojë me mirënjohje të gjithë grupet shoqërore, qytetarët e veçantë dhe institucionet, që ndërvepruan me ILD-në përgjatë vitit 2023, për vlerësimet, kritikat por edhe sugjerimet, për të kontribuar në forcimin e institucionit, por edhe të besimit tek sistemi i drejtësisë, përmes kultivimit të së drejtës, si vlerë shoqërore, përmes edukimit ligjor me parimet e shtetit të së drejtës.

**Gjatë vitit 2023, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka qenë objekt analizash studimore profesionale nga Organizata të Shoqërisë Civile, që kanë në fokus të punës, monitorimin e sistemit të drejtësisë. Instituti për Studime Politike dhe Ligjore, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes dhe Infocip përmes eventeve të posaçme, kanë paraqitur dhe diskutuar bashkë me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, me profesionistë të fushës dhe përfaqësues institucionesh, ecurinë e veprimtarisë së ILD-së, sfidat dhe përparimet, si dhe vizionin për të ardhmen.**







***Gjatë asistimit të ankuesve***

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.






***Gjatë muajit Janar 2024,* Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun *ka pritur 21 ankues, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe 22 telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.***



## KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuesin për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

## SHIFRA MUJORE

*Gjatë muajit **Janar 2024**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **18 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuesit t'i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).*





## VENDIMET ME SHPALLJE,
## TRANSPARENCË DHE QYTETARË TË INFORMUAR

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka pasur dhe vijon të ketë në qendër të vëmendjes qytetarin, jo vetëm si ankues, që depoziton shkelje disiplinore të pretenduara ndaj magjistratëve, por edhe si qytetar i informuar. Një prej rrugëve për të qenë më afër qytetarit me vendimmarrjet e tij janë vendimet me shpallje, jo vetëm si një detyrim ligjor, por edhe një mënyrë për të informuar në kohë dhe sa më shpejtë qytetarin-ankues.

Që prej ngritjes së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vëmendja ndaj qytetarëve-ankues ka qenë e lartë, si për ata që i janë drejtuar direkt ILD-së, ashtu edhe për të tjerë, që ankesat e tyre i kishin depozituar prej vitesh në institucionet paraardhëse, të ngarkuara me procesin disiplinor të magjistratëve.

Në funksion të parimit, se një qytetar i informuar arrin të adresojë ku duhet problematikën që has, Zyra e Inspektorit të

**Gjatë vitit 2023, janë publikuar në mjediset e ILD , Njësitë e qeverisjes vendore, si dhe në faqen zyrtare të internetit 350 vendime me shpallje, në zbatim të nenit 162 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë".**

Lartë të Drejtësisë po ndjek një strategji komunikimi publik, që nis në institucion, me lehtësitë e krijuara për çdo ankues, përmes faqes së internetit, ku ndodhet një formular i dedikuar për t'u plotësuar, e më tej, çdo ditë, me pritjen dhe asistimin e qytetarëve, që duan të depozitojnë ankesë fizikisht, apo të marrin informacion për ecurinë e ankesës së tyre.

Pjesë e këtij angazhimi sistematik të ILD-së është edhe informacioni fundor për ankuesin, pra vendimi që është marrë mbi ankesën e tij. Për këtë arsye Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përveç njoftimit sipas ligjit, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", bën njoftimin publik të vendimit për një afat 10 ditor, përfshi edhe publikimin në faqen zyrtare në internet të institucionit.

Nga ana tjetër, në të gjitha rastet e mosgjetjes së ankuesve, në adresat që ata kanë lënë me paraqitjen e ankesës, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun tenton komunikimin, për t'u dorëzuar vendimin, krahas procedurës që parashikon ligji, përmes publikimit të njoftimit me shpallje publike, në njësinë përkatëse të Qeverisjes Vendore, prej nga ka ardhur ankesa e qytetarit.

Ky komunikim i shtuar i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i shërben rritjes së transparencës, por edhe të efiçencës së punës së ILD-së, si një mënyrë për të ndikuar në rritjen e forcimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

Gjithashtu, njoftimet me shpallje janë pjesë e Programit të Transparencës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në publikimin e informacionit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mban parasysh interesin e ankuesit dhe informacionin që i përket atij, për ta marrë në kohën dhe mënyrën e duhur.

Gjatë vitit 2023, janë publikuar në mjediset e ILD , Njësitë e qeverisjes vendore, si dhe në faqen zyrtare të internetit 350 vendime me shpallje, në zbatim të nenit 162 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë".

**Noftimet me shpallje janë parashikuar edhe në Programin e Transparencës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në publikimin e informacionit, Inspektori i Lartë i Lartë i Drejtësisë mban parasysh interesin e ankuesit dhe informacionin që i përket atij, për ta marrë në kohën dhe mënyrën e duhur. Ky komunikim direkt i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i shërben rritjes së transparencës, por edhe të eficencës së punës së ILD-së, duke ndihmuar gjithashtu në rritjen e forcimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.**

# ILD NË TWITTER

**Inspektori i Larte i Drejtesise** @ILD_A · Jan 6

Faleminderit pjesëmarrësve të Akademisë së Integrimit Europian dhe Negociatave për kontributet mbi punën e #ILD -së dhe sistemit të drejtësisë, pavarësinë, sjelljen e magjistratëve, perceptimin publik dhe realitetin. Ishtë kënaqësi komunikimi me ju. #ILD⚖️ #AIEN




1 · 7 · 79

**Inspektori i Larte i Drejtesise** @ILD_A · Jan 6

“Dëgjoj referenca të tilla si “drejtësia e re”.Në fakt ka një sistem të ri drejtësie e jo “drejtësi të re” sepse janë të njëjtët njerëz, që kanë qenë pjesë e një sistemi tjetër organizimi e tani janë në një sistem të ri, me më shumë kompetenca e pavarësi




From ild.al

1 · 2 · 50

**Inspektori i Larte i Drejtesise** @ILD_A · Jan 6

Po ndodh: me studentet e Akademise se Integrimit Europian dhe Negociatave per te ndare mendime mbi shtetin e se drejtes, efikasitetin e sistemit te drejtesise dhe rolin e #ILD-se⚖️ #aien #drejtesia #integrimi



1 · 6 · 112

**Inspektori i Larte i Drejtesis** @ILD_ · Jan 29

Si cdo të hënë, përpunimi javor i ankesave #ILD
✅5852 të konfirmuara
✅5014 të trajtuara
✅838 në proces trajtimi
✅236 në verifikim pas shqyrtimit fillestar
✅108 Magjistratë të hetuar
Më shumë👉 ild.al
Na thoni eksperiencën tuaj me ne👇
ild.al/sq/ankete/




1 · 3 · 29

# JANARI NË ILD ME SHIFRA

Gjatë muajit **Janar** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **79 ankesa.**

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Janar 2024**. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

| ARKIVIME | VERIFIKIME | PROCESI DISIPLINOR |
|---|---|---|
| **94 vendime nga 159 ankesa të shqyrtuara,** konkretisht:<br><br>- 73 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar<br><br>- 21 vendime arkivimi pas verifikimit | - 26 vendime verifikimi, nga praktikat e ILD-së. | -**2 vendime për fillim hetimi disiplinor** për 1 gjyqtar dhe 1 prokuror<br><br>-**2 kërkesa për procedim disiplinor** për dy gjyqtare |

# ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

* mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
* të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13, Tiranë.
* mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevoje, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD **www.ild.al**, në seksionin "**Si pranohen ankesat**".

# SHPALLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Janar 2024** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **12 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarritshëm në adresat e komunikuara prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.





**JANAR 2024**

**Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.**

**© ILD**




# KONTAKT ILD

**WEB:** ild.al

**EMAIL:** info@ild.al

**ADRESA:** Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri







*Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD*

Më skano!